




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



**Strategjia e Teknologjisë dhe Inovacionit në Mësimdhënie e Nxënie
2026 - 2028**

Miratuar me Vendimin e Dekanatit
Nr. 08 datë 02.03.2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

1. Hyrje

Zhvillimi i teknologjisë dhe inovacionit përbën një nga shtyllat kryesore për modernizimin e arsimit të lartë dhe për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve akademike. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja synon të ndërtojë një qasje të qëndrueshme dhe të integruar ndaj teknologjisë dhe inovacionit, duke u bazuar në standardet bashkëkohore dhe nevojat e studentëve.

Qëllimi kryesor:

Integrimi i vazhdueshëm i teknologjisë në të gjitha nivelet e veprimtarisë akademike, përmes përdorimit të mjeteve digjitale, metodave moderne të mësimdhënies dhe zhvillimit të aftësive digjitale të studentëve dhe stafit akademik.

2. Veprimet Kryesore

2.1. Infrastruktura Teknologjike

Shfrytëzimi i laboratorëve teknologjikë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me kapacitetin dhe funksionalitetin e tyre.

a) Laboratori i Përkthimit Audio-Vizual

Programet që do të përdoren:

- **Sketch Engine** – Platformë profesionale për gjuhësi, përkthim, leksikografi dhe kërkim shkencor, që mbështet mësimdhënien bazuar në të dhëna reale gjuhësore.
- **EZTitles** – Për krijimin, redaktimin dhe sinkronizimin e titrave, duke mbështetur përkthimin audiovizual dhe aftësitë praktike në fushën e medias digjitale.
- **EasySub** – Për titrim automatik dhe redaktim të titrave, duke ndihmuar në përkthimin audiovizual dhe zhvillimin e aftësive digjitale.
- **SPSS** – Program i specializuar për analizën statistikore të të dhënave, i dobishëm për kërkimin shkencor dhe studimet gjuhësore e arsimore.

b) Laboratori i Përkthimit

Laboratori i Përkthimit do t'ju vijë në ndihmë për zhvillimin e aftësive të përkthimit profesional dhe menaxhimit të memories së përkthimit. Ai përdor SDL Trados Studio, duke rritur cilësinë dhe konsistencën e përkthimeve dhe duke i afruar studentët me standardet bashkëkohore të tregut të punës.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

c) Laboratori Kërkimor “DiPLing”

Laboratori Kërkimor DiPLing do t’ju vijë në ndihmë për zhvillimin e projekteve kërkimore, analizën e të dhënave dhe praktikën shkencore në fushën e gjuhësisë, përkthimit, letërsisë dhe didaktikës së gjuhëve të huaja.

Programi **SPSS** i instaluar në kompjuterët e laboratorit mundëson analiza statistikore të avancuara, duke mbështetur kërkimin shkencor dhe procesin mësimor sipas standardeve bashkëkohore.

d) Laborator i Trajnimit Automatik të Gjuhëve

Laboratori i Trajnimit Automatik të Gjuhëve do t’ju vijë në ndihmë stafit akademik dhe studentëve për zhvillimin e aftësive digjitale dhe teknologjike në fushën e përpunimit të gjuhës natyrore dhe Inteligjencës Artificiale. Ai ofron mundësi për trajtimin e materialit gjuhësor, nxjerrjen automatike të kuptimit nga tekstet, ndërtimin e chatbots, zhvillimin e rrjeteve neuronale dhe përdorimin e të dhënave gjuhësore në sisteme informatike të dedikuara.

Ky laborator i përgatit studentët dhe stafin akademik për sfidat e tregut të punës dhe inovacionin në mësimdhënie, me aplikime në përkthim, e-learning, komunikime digjitale, marketing, financa dhe sektorë të tjerë profesionalë.

e) Laborator i Fonetikës

Laboratori i Fonetikës do të shërbejë si hapësirë e specializuar për zhvillimin e aftësive të shqiptimit dhe analizës fonetike, duke integruar pajisje audio dhe softuerë bashkëkohorë për regjistrim dhe analizë të të folurit, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

f) Laborator i Kërkimit Shkencor

Laboratori i Kërkimit Shkencor do të shërbejë për zhvillimin e projekteve kërkimore, analizën e të dhënave dhe praktikën shkencore në fushën e gjuhësisë, përkthimit, letërsisë dhe didaktikës së gjuhëve të huaja.

**Këto teknologji mbështesin drejtpërdrejt studimet gjuhësore, përkthimin profesional dhe audiovizual, si dhe analizën e të dhënave. Përdorimi i tyre nxit inovacionin akademik dhe përgatit studentët për tregun e punës, duke i afruar Fakultetin me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë.*

2.2. Rrjeti i Brendshëm Digjital - Intranet





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Krijimi i një rrjeti të brendshëm digjital për komunikim, shpërndarje informacioni dhe menaxhim të burimeve akademike në mënyrë të sigurt dhe të strukturuar, duke rritur efikasitetin dhe transparencën brenda institucionit.

2.3. Zhvillimi i Aftësive Teknologjike

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja do të investojë në zhvillimin sistematik të kompetencave digjitale të stafit akademik dhe studentëve.

- Organizimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin akademik mbi përdorimin e platformave digjitale dhe integrimin e teknologjisë në mësimdhënie, sipas profilit të lëndëve.
- Organizimi i trajnimeve periodike për studentët me qëllim rritjen e kompetencave digjitale dhe përdorimin efektiv të mjeteve teknologjike në procesin mësimor.
- Trajnime për përdorimin e platformave akademike si eStudent, Microsoft Teams, Google Classroom dhe Google Workspace.
- Trajnime për përdorimin e programeve profesionale si SPSS, SDL Trados Studio, Sketch Engine, EZTitles, EasySub, si dhe paketës Microsoft Office (Word, PowerPoint, Excel) dhe Canva.
- Workshop-e mbi përdorimin e Inteligjencës Artificiale dhe mjeteve digjitale në kërkimin shkencor.
- Trajnime mbi kërkimin akademik në bibliotekat digjitale dhe databazat ndërkombëtare.
- Zhvillimi i aftësive në fushën e sigurisë kibernetike dhe kulturës digjitale.

Platformat mbështetëse

- Microsoft Teams dhe Microsoft 365 (përfshirë Copilot) për bashkëpunim, organizim akademik dhe mbështetje në procesin e mësimdhënies.
- Google Classroom dhe Google Workspace për organizimin e lëndëve, shpërndarjen e materialeve mësimore dhe bashkëpunimin në kohë reale.
- Platforma eStudent, për të cilën do të organizohen trajnime të detyrueshme dhe udhëzime të detajuara për përdorim korrekt dhe efikas të shërbimeve akademike online.

****Studentët dhe stafi do të zhvillojnë kompetenca digjitale të avancuara, përdorim efektiv të platformave dhe programeve profesionale, dhe rritje e aftësive në sigurinë kibernetike.***





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

2.4. Biblioteka Digjitale

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ofron qasje të gjerë në literaturë akademike dhe burime ndërkombëtare, si në bibliotekat fizike ashtu edhe në bibliotekat online, duke përfshirë së fundmi edhe Bibliotekën Digjitale të Fakultetit.

<https://biblioteka.fgjh.edu.al/#/app/landing>

-Siguron qase të plotë për studentët dhe personelin akademik dhe në biblioteka të tjera digjitale:

<https://ulibrary.rash.al/>

<https://www.jstor.org/>

<https://cs.cobiss.net/clib/utfhf/login>

<https://www.ub.uni-muenchen.de/index.html>

2.5. Mbështetje për Kërkime dhe Projekte

Fakulteti ka mbështetur studentët për kërkime shkencore dhe projekte studimore përmes krijimit të Laboratorit dhe Qendrës së Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe do të vazhdojë të ofrojë mbështetje për:

- Hapësira të dedikuara për kërkime dhe projekte studimore.
- Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe evropiane për zhvillimin e kompetencave digjitale dhe inovacionin në mësimdhënie.
- Mbështetje për aplikime dhe bashkëpunime ndërkombëtare.

2.6. Ndërkombëtarizimi dhe Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja synon të forcojë dimensionin ndërkombëtar të veprimtarisë akademike përmes integritit të teknologjisë në bashkëpunimet me institucionet partnere, duke krijuar një mjedis të hapur, inovativ dhe të ndërlidhur globalisht.

Në këtë kuadër, do të ndërmerren këto veprime:

- Nxitja e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik në kuadër të programeve ndërkombëtare (Erasmus+).





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

- Organizimi i leksioneve të hapura, seminareve dhe workshop-eve online me pedagogë dhe ekspertë të huaj.
- Bashkëpunimi në projekte kërkimore ndërkombëtare në fushën e gjuhësisë, përkthimit, teknologjive gjuhësore dhe inovacionit në mësimdhënie.

Integrimi i praktikave më të mira ndërkombëtare në procesin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

**Kjo qasje synon të rrisë cilësinë akademike, të zhvillojë kompetencat ndërkulturore dhe digjitale të studentëve, si dhe të pozicionojë Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në një rrjet bashkëpunimi ndërkombëtar bashkëkohor.*

Miratoi

Dekan

Prof. Dr. Esmeralda KROMIDHA

